



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHTETIT**

N J O F T I M

***PËR KANDIDATËT APLIKANTË PËR PROVIMIN E SHTETIT NË
PROFESIONET E RREGULLUARA NË FUSHËN E MJEKËSISË***

SEZONI XXVI

Për të gjithë kandidatët aplikantë për pjesëmarrje në provimin e shtetit në profesionin e rregulluar të Mjekut, Farmacistit, Infermierit, Mamisë, Fizioterapistit, Teknikut të Imazherisë, Teknikut të Labororit dhe Logopedistit, ju bëjmë me dije se provimet do të zhvillohen në godinën e Qendrës së Shërbimeve Arsimore (Bulevardi “Zhan D’Ark”, Nr. 23, Tiranë, ish-ATSH), sipas kalendarit të publikuar.

1. Kandidati duhet të paraqitet pranë QSHA-së 30 minuta përpara orarit të publikuar dhe të jetë i pajisur me:

- Letërnjoftim (Kartë ID ose Pasaportë, dokumenti origjinal);
- Kopje të Kartës ID ose Pasaportës;
- Faturën origjinale me vulën përkatëse, të pagesës së tarifës së provimit për llogari të QSHA, të kryer në një bankë të nivelit të dytë (sipas faturës për arkëtim të publikuar në faqen zyrtare të QSHA, <http://qsha.gov.al/DPSH/fatura.html>, bazuar në herën e pjesëmarrjes në provim);

Kandidatët, të cilët nuk paraqesin dokumentet e mësipërme, nuk mund të marrin pjesë në provim.

2. Kandidati gjatë zhvillimit të provimit duhet të zbatojë rregullat e mëposhtme:

- ndalohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve apo mjeteve të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të provimit, pasi kjo vlerësohet si kriter mos kualifikimi;
- ndalohet komunikimi me kandidatët e tjerë gjatë zhvillimit të provimit deri në marrjen e deklaratës së rezultatit;
- ndalohet lëvizja përtej vendit të përcaktuar për zhvillimin e provimit;
- ndalohet duhani dhe konsumimi i ushqimit në mjediset e provimit.

Orari i pjesëmarrjes në provim do të jetë i përcaktuar dhe nuk mund të ketë ndryshime.

Lutemi që kandidatët të verifikojnë paraprakisht të dhënat në listat e publikuara në faqen zyrtare të QSHA-së www.qsha.gov.al dhe në rast pasaktësish t’i drejtohen Urdhrave Profesionalë.

Ju urojmë Suksese!